

KISHA E SHËN SOTIRËS - VUNO / HIMARË






Kisha e Shën Sotirës është një kishë e vogël një nefëshe me çati dyujëse. Piktura murale që dekoron kishën shihet tek absida e vogël si dhe nikja në faqen lindore të bemës. Kisha e Shën e Sotirës, në Vuno, është shpallur monument kulture i kategorisë së parë, në 1979.

Problematika e monumentit:


- Degradim i pjesshëm i mbulesës së çatisë .
- Mungesë e shtresës së petavrave dhe hidro-izolimit në çati.
- Degradim i elementëve drusorë (derës).
- Mungesë e shtresës së pllakave të gurit në dysheme.
- Degradim i murit mbajtës në anën lindore.

Ndërhyrjet konservuese - restauruese:

- Zëvendësimi i elementëve që janë jashtë kushteve teknike në konstruksionin e çatisë.
- Restaurimi i çatisë, denzifiktim i elementëve të drurit me antimol dhe lyerje me vaj lini.
- Vendosje e petavrave dhe hidro-izolimit në çati.
- Mbulimi i çatisë me tjegulla vendi .
- Shtrim me pllaka guri i dyshemesë.
- Vendosje derë e re druri.
- Konsolidimi i murit mbajtës në anën lindore.
- Sistemimi dhe pastrimi i territorit.



PAMJA NGA VERIU SHK 1:50



PAMJA NGA JUGU SHK 1:50

